

VENDIM
Nr. 286, datë 28.5.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 113, DATË 6.3.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE QË PËRFAQËSOJNË
PALËN SHQIPTARE NË KOMISIONIN SHQIPTARO-MALAZEZ PËR
MENAXHIMIN E UJËRAVE ME INTERES TË PËRBASHKËT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të kreut III, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, të miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 113, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët”, të ndryshuar, shkronjat “a”, “c”, “ë” dhe “g” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) znj. Anila Shehu, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;”;

“c) z. Alfred Çerepi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;”;

“ë) z. Neritan Postoli, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;”;

“g) znj. Xhemi Jaupaj, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku